LIGJ
Nr.9243, datë 17.6.2004

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8607, DATË 27.4.2000 "STATUSI I DËSHMORIT TË ATDHEUT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Pas shkronjës "e" të nenit 2 shtohet shkronja "e/1" me këtë përmbajtje:

"e/1) shtetasve shqiptarë që kanë rënë ose bien në krye të detyrës për mbrojtjen e paqes dhe të lirisë së kombit shqiptar, ose atyre që kanë rënë apo bien në mbrojtje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar ose për mbrojtjen e pasurisë shtetërore, apo që humbasin jetën në krye të detyrës nga rreziqet e fatkeqësitë natyrore.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4271, datë 14.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu